



Pranimi / Dorezuar Punime/Protokole Received/Delivered	31.03	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SRIMSHOR/1764/2022			1/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.179/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2836/2021 të datës 28.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.799/2021 të datës 13.09.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër Vendimit me numër KA.nr.29/2021 të datës 06.07.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.799/2021 e datës 13.09.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KA.nr.29/2021 i datës 06.07.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi fillimisht me datë 26.02.2021 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit numër KA.nr.02/2021 të datës 14.01.2021 Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës pasi që i njëjti e kishte lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 30.10.2020, ndërsa Këshilli e kishte aprovuar ankesën e ankuesit dhe lëndën e kishte kthyer në ri-shqyrtim për shkak të metave ligjore të akteve të kontestuara.

Ankuesi [redacted] me datë 13.09.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4582/2021 të regjistruar me A.nr.799/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Numër KA.nr.29/2021 të datës 06.07.2021 të cilin e sipas shkresave të lëndës e kishte pranuar me datë 18.08.2022, me pretendimet për shkelje të ligjit material dhe procedural dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike me arsyetimin se i njëjti e kishte lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 26.04.2021 përmes të cilit i ishte shqiptuar masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.09.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Më datë 08.10.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 27.10.2021, me numër protokoll 5185/2021, ka njoftuar ankuesin [redacted] se nuk mund të shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesën A.nr.799/2021, të datës 13.09.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me njoftimin e datës 27.10.2021, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 22.02.2022, me numër A.nr.2836/2021, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 27.10.2021, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.799/2021, të datës 13.09.2021 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4582/2021 të datës 13.09.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.09.2021; Njoftim i datës 27.10.2021; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.2836/2021 i datës 28.02.2022; Fletë kthesë e datës 08.11.2021; Fletë kthesë e datës 23.09.2021; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.105/2021 i datës 02.04.2021; Vendim KA.nr.29/2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 06.07.2021; Përgjigje në ankesë e datës 08.10.2021; Ankesë me numër 01/1066 e datës 07.06.2021; Fletë kthimi nga posta i datës 18.05.2021; Vendim KD.Nr.10/2020/1 i Komisionit Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 26.04.2021; E-mail nga L.S. për B.G. i datës 16.06.2020; E-maili nga B.G. për N.K. i datës 11.06.2020; E-mail nga J.D. për B.G. i datës 08.10.2020; E-mail nga B.G. për E.V. i datës 13.01.2021; E-mail nga J.D. për B.G. i datës 28.12.2020; E-mail nga B.G. për J.D. i datës 28.12.2020; E-mail nga J.D. për B.G. i datës 02.12.2020; E-mail nga B.G. për J.D. i datës 02.12.2020; E-mail nga B.G. për B.H. i datës 02.11.2020; E-mail nga H.B. për B.G. i datës 02.11.2020; Shkresë e

marrë nga B.H. i datës 24.11.2020; Vendim KA.nr.02/2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 14.01.2021; Fletë kthesë nga Gjykata Themelore e datës 27.11.2020; Vendim me numër K.D. 10/2020 i Komisionit Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 30.10.2020; Fletë dërgesë për dorëzim personal e datës 28.10.2020; Fletë dërgesë për dorëzim personal; Thirrje për shqyrtim kryesor nga Gjykata Themelore në Mitrovicë i datës 27.10.2020; Dosja e Pushimit vjetor nga Gjykata Themelore Mitrovicë e B.H. e vitit 2020; E-mail nga D.Gj. për B.G. i datës 27.10.2020; E-mail nga J.D. për B.G. i datës 27.10.2020; E-mail nga B.G. për J.D. i datës 26.10.2020; Aktvendim nga Gjykata Themelore e Mitrovicës me numër GJA.nr.19/2020 i datës 30.07.2020; Raport mjekësor për B.H. i datës 27.07.2020; Raport mjekësor për B.H.; Pajtim për transferim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me numër 03/5/142/2020 i datës 09.06.2020; Kërkesë për transferim të përhershëm në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me numër 03/5/142/2020 i datës 09.06.2020; Pajtim për transferim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë i datës 09.06.2020; Kërkesë për transferim të përhershëm në Gjykatën Themelore në Mitrovicë i datës 09.06.2020; Akt Emërim i B.H. me nr. refe:DS-407/2020 i datës 01.07.2020; E-mail nga B.G. për J.D. i datës 27.10.2020; E-mail nga B.G. për B.H. i datës 27.10.2020; E-mail nga D.GJ. për B.G. i datës 27.10.2020; Dosja e pushimit vjetor e vitit 2020 e B.H. shtojca nr. 2; Dosja e pushimit mjekësor e vitit 2020 e B.H. shtojca nr.2; E-mail nga J.D. për B.G. i datës 27.10.2020; E-mail nga B.G. për J.D. i datës 26.10.2020; Raport mjekësor për B.H. i datës 27.07.2020; Njoftim nga Gjykata Themelore në Mitrovicë me numër GJA.nr.148/2020 i datës 08.10.2020; Ankesë me numër 01/1273 i datës 21.12.2020; E-mailin e datës 23.03.2022 me numër prot:1528/2022; E-mailin e datës 30.03.2022 dërguar nga Zyrtarja e Personelit të SKGJK-së për Këshillin; Fletë kthesa e postës e datës 18.08.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit

është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Numër KA.nr.29/2021 të datës 06.07.2021, me pretendimet për shkelje të ligjit material dhe procedural, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit të masës së shqiptuar disiplinore.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi e ka themeluar marrëdhënien e punës fillimisht pranë Akademisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, ndërsa më pas sipas Marrëveshjes për Transferimin e Nëpunësve Civil ndërmjet Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Akademisë së Drejtësisë të datës 30.06.2020 me numër:01/591 ankuesi është transferuar në mënyrë të përhershme me pëlqimin e tij nga data 01.07.2020 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe sipas Akt Emërimit të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 30.06.2020 i njëjti ushtron pozitën "Zyrtar për Përkthime".

Kolegji po ashtu ka gjetur se sipas njoftimit me numër GJA.nr.148/2020 të datës 08.10.2020, Administratorja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë pranë Komisionit Disiplinor të SKGJK-së ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankuesit me pretendimet se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të disiplinës në punë, duke munguar pa arsye katër (4) ditë të njëpasnjëshme në punë dhe duke mos lajmëruar mungesën e tij, ndërsa Kolegji konstatuar se ankuesi e ka shfrytëzuar pushimin mjekësor prej datës 27.07.2020 deri më datë 31.07.2020, në kohëzgjatje prej pesë (5) ditëve, ndërsa me vendimin GJ.A.nr.19/2020 të datës 30.07.2020 i është caktuar pushim vjetor prej tridhjetë (30)

ditësh nga data 03.08.2020 deri me datë 11.09.2020 të cilin e ka shfrytëzuar. Ndërsa nga data 14.09.2020 deri me datë 02.10.2020 ka qenë në pushim mjekësor në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe i njëjti pas përfundimit të pushimit mjekësor është dashtë që të paraqitet në vendin e punës me datën 05.10.2020 por që i njëjti nuk është paraqitur në vendin e punës më këtë datë dhe as nuk e ka lajmëruar mungesën e tij tek eprori siç obligohet edhe me dispozitat ligjore.

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës pas ri-shqyrtimit të lëndës së ankuesit sipas detyrimeve ligjore të Vendimit të Këshillit A.nr.105/2021 të datës 02.04.2021 me vendimin K.D.10/2020 Ref. DS-191-2021 të datës 26.04.2021 ka vendosur ta shpallë përgjegjës ankuesin për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 6 pika 1.13 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *"Shkelje të rënda serioze konsiderohen: mos-informimi dhe mungesa e pa arsyeshme për dy (2) ditë në punë të njëpasnjëshme"* si dhe nenin 59 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e institucionit punëdhënës. Nëpunësit civilë janë të detyruar të respektojnë orarin e punës dhe ta shfrytëzojnë atë për kryerjen e detyrave të caktuara. 2. Nëpunësit civilë janë të detyruar t'i informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mos informimi ose mungesa e pa lajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin"*, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor ka vendosur në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës neni 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, pika 1.2.4 ku përcaktohet se: *"Vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: Për shkelje të rëndë aplikohen masat disiplinore në vijim: ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension"* pasi që mungesa në punë për më shumë se dy (2) ditë respektivisht në rastin konkret katër (4) ditë, përbën shkelje të rënda të detyrave të punës, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara sikurse rregullohet edhe me dispozitat e nenit 7 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 05/2012 e Orarit të Punës, i cili përcakton se: *"Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, nëpunësi civil duhet të marr leje nga menaxheri drejtues"*.

Po ashtu, Këshilli bazuar në bazën e të dhënave të shqyrtimit të ankesave dhe nxjerrjes së vendimeve ka gjetur se ndaj të njëjtit ankues ka vendosur lidhur me ankesën e tij të datës 23.09.2019 sipas aktgjykimit A.nr.2445/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative përmes vendimit A.nr.275/2019 dhe njëherit e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor të Akademisë së Drejtësisë të datës 15.02.2019 ku i ishte shqiptuar masa disiplinore *"Pezullim i ushtrimit të detyrës dhe ndalim të 1/3 e rrogës për dy (2) muaj"*, nga rrjedh se ankuesi edhe në të kaluarën ka vepruar në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit e punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me KA.nr.29/2021 i datës 06.07.2021, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Rregulloren Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike me rastin e lënies në fuqi të masës disiplinore.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.179/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
- Arkivit të KPMSHCK-së

